

V E N D I M
Nr.13, datë 14.5.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtari
Manol Konomi,	Anëtari
Feti Gjilani,	Anëtari
Alfred Karamuço,	Anëtari
Veli Budo,	Anëtari
Zija Vuci,	Anëtar i“““
Franc Jakova,	Anëtari

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 13.05.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.22 Akti, që i përket :

K E R K U E S E : PARTIA ALEANCA DEMOKRATIKE E SHQIPERISE, e përfaqësuar nga Z. Arben Demeti.

PALE E INTERESUAR : KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE, në mungesë.

O B J E K T I :

Shfuqizimi i Vendimit nr.341 Prot., datë 5.5.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për mosregjistrimin e Z. Idriz Basha si kandidat për deputet i Partisë Aleanca Demokratike në zonën elektorale nr.9 dhe shfuqizimi i Vendimit nr.348 Prot., datë 2.5.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për mosregjistrimin e Z. Arben Saraçi si kandidat për deputet i Partisë Aleanca Demokratike në zonën elektorale nr.87.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

1. Më datë 26.4.1996 Partia Aleanca demokratike si subjekt elektorale i ka dorëzuar komisionit të zonës elektorale nr.9 dokumentet për regjistrimin e Z. Idriz Basha si kandidat për deputet të saj në këtë zonë. Sipas parashtrimeve të palës kërkuese në kërkesën e paraqitur pranë kësaj Gjykate dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, Z. Idriz Basha, shtetas shqiptar, qysh para disa dekadash është larguar nga Shqipëria dhe është vendosur në Belgjikë; në Republikën e Shqipërisë ka qëndruar vetëm në muajt tetor-nëntor 1995 dhe ka vajtur përsëri në Belgjikë, ku më 19 dhjetor 1995 ka pësuar një aksident të rëndë dhe ka qëndruar atje në spital e nën kontrollin e mjekut deri në 30.4.1996.

Në komisionin e zonës, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe, së fundi, gjatë shqyrtimit të çështjes në këtë Gjykatë pala kërkuese nuk paraqiti prova që Z. Idriz Basha gjatë 6 muajve të ketë pasur vendbanim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese vendimin datë 30.4.1996 të komisionit të zonës nr.9 dhe vendimin nr.Prot.341, datë 5.5.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për mosregjistrimin e Z. Idriz Basha si kandidat për deputet i gjen të mbështetura në nenin 2 të Ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me Ligjin nr.8055, datë 1.2.1996, i cili përcakton, ndër të tjera, edhe kushtin e domosdoshëm për të pasur të drejtën për t’u zgjedhur deputet në Kuvendin Popullor - vendbanimin e përhershëm në Republikën e Shqipërisë për një periudhë kohe jo më pak se 6 muaj.

Në kërkesën e saj Partia Aleanca Demokratike ka parashtruar gjithashtu se kërkesa e nenit 2 të ligjit të sipërcituar që ve kusht vendbanimin e përhershëm në Republikën e Shqipërisë jo më pak se 6 muaj për të fituar të drejtën për t’u zgjedhur si deputet, vjen në kundërshtim me nenin 19 të Ligjit Kushtetues nr.7692, datë 31.03.1993 “Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”. Lidhur me këtë kërkesë Gjykata konstaton se pala kërkuese si parti politike nuk hyn në subjektet e parashikuara në nenin 25 të Ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, të cilat kanë të drejtë të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Edhe sigla e vënë nga Z. Idriz Basha në kërkesën e Partisë Aleanca Demokratike, pa u

paraqitur vetë dhe parashtruar kërkimet e tij për shkelje të të drejtave kushtetuese, nuk e investon Gjykatën për të shqyrtuar kushtetutshmërinë e nenit 2 të ligjit të sipërcituar.

2. Më datë 26.4.1996 Partia Aleanca Demokratike si subjekt elektoral i ka dorëzuar komisionit të zonës elektorale nr.87 dokumentet për regjistrimin e Z. Arben Saraçi si kandidat për deputet të saj në këtë zonë.

Komisioni i zonës me vendimin datë 30.4.1996 ka refuzuar regjistrimin e Z. Arben Saraçi si kandidat për deputet me arsyetimin se 18 nga personat që kanë nënshkruar listën prej 406 zgjedhësish që përkrahin paraqitjen e kandidatit nuk janë banorë të fshatit Poshnje, pra nuk është respektuar kërkesa e shkronjës “ç” të nenit 13 të Ligjit “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”. Po me këtë arsyetim Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me Vendimin nr.348 Prot., datë 2.5.1996 ka rrëzuar kërkesën e Partisë Aleanca Demokratike për prishjen e vendimit të komisionit të zonës.

Gjykata konstaton se të dy këto vendime janë marrë pa u respektuar procedura e parashikuar në paragrafin e tretë të nenit 14 të Ligjit “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, në të cilin thuhet : “Kur komisioni i zgjedhjeve i zonës vëren parregullsi në kërkesën dhe dokumentet për regjistrimin e kandidatëve, njofton subjektet elektorale për ndreqjen e tyre brenda dy ditëve nga konstatimi. Në rast të kundërt, komisioni i zgjedhjeve i zonës merr vendimin përkatës”.

Rrjedhimisht, Gjykata çmon se vendimi i komisionit të zonës nr.87 dhe Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhen shfuqizuar; komisioni i zonës nr.87 duhet t’i japë dy ditë afat palës kërkuese për ndreqjen e parregullsive që konstaton në dokumentet për regjistrimin e kandidatit dhe vetëm pastaj të marrë vendimin përkatës.

PER KETO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 50 të Ligjit Nr.7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me Ligjin Nr.8055, datë 1.2.1996 , me shumicë votash,

V E N D O S I :

1. Rrëzimin e kërkesës së Partisë Aleanca Demokratike për shfuqizimin e Vendimit nr.341 Prot., datë 5.5.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për mosregjistrimin e Z. Idriz Basha si kandidat për deputet i Partisë Aleanca Demokratike në zonën elektorale nr.9;

2. Shfuqizimin e Vendimit datë 30.04.1996 të komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.87 dhe Vendimit nr.348 Prot., datë 2.5.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për mosregjistrimin e Z. Arben Saraçi si kandidat për deputet i Partisë Aleanca Demokratike në zonën elektorale nr.87.

Detyrimin e komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.87 t’i japë subjektit elektoral Partia Aleanca Demokratike 2(dy) ditë afat për ndreqjen e parregullsive të konstatuara në dokumentet për regjistrimin e kandidatit për deputet Z. Arben Saraçi dhe në përfundim të marrë vendimin përkatës.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më datë 14.5.1996